



## Drejtoria për Arsim dhe Kulturë

05.Nr.225 /18  
Me 24.05.2018

### OFERTË

Për angazhimin e mësimitdhënësve në trajnimin për trajner sipas fushave të Kurikulës së re të Kosovës Divizioni për Zhvillim Profesional i Mësimitdhënësve nga MASHT-i ka planifikuar aktivitete që duhet të ndërmerren për mbështetjen profesionale të mësimitdhënësve për zbatimin e Kurikulës së re të Kosovës. Këto aktivitete kanë për qëllim të vendosin skemën e trajnimit të mësimitdhënësve për të gjitha komunat e Kosovës për vitin shkollor 2018/2019, të cilat do të punojnë me kurrikulën e re. Ky plan i veprimit, përcakton objektivat kryesore për mbështetjen profesionale të mësimitdhënësve për zbatimin e Kurikulës së re të Kosovës, realizimi i të cilës do të ofrojë cilësi më të mirë të përkrahjes së nxënësve drejt zotërimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me kurrikulën shtetërore.

Në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e DZHPM -MASHT për të aftësuar mësimitdhënësit për trajnerët dhe ekspertët në nivel të komunave të Kosovës për krijimin e grupeve profesionale që ndihmojnë zbatimin e reformës arsimore, MASHT-i në bashkëpunim me DKA-në shpallë ofertë për përzgjedhjen e mësimitdhënësve për trajnerë sipas fushave të Kurikulës së re të Kosovës, të cilët duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të jetë mësimitdhënës i rregullt në shkollat publike të Republikës së Kosovës, përparësi ka mësimitdhënësit e licencuar.
2. Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në mësimitdhënie/arsim;
3. Të jetë në lëmin/fushën përkatëse për të cilat është i thirrur për mbajtjen e trajnimeve të akredituara nga MASHT-i.
4. Të jenë të certifikuar sipas programeve për mësimitdhënie, udhëheqje arsimore e programe tjera relevante të akredituara nga MASHT-i, e sidomos nga programet bazike/themelore dhe pjesmarres në trajnimet, organizimet e veçura ku prezentohen strategji dokumente relevante për çështjet e arsimit.
5. Të ketë dëshmi/raport vlerësues nga drejtori i shkollës për rezultatet e punës me nxënës si mësimitdhënës i certifikuar në programet e përmendura më lartë;
6. Të njohë mirë Kurrikulën e re të Kosovës, me përparësi për ata kandidat (mësimitdhënës) të cilët kanë qenë në pilotim dhe zbatim të KK-së së Re.
7. Të njohë mirë teknikat e prezantimeve me kompjuter të jetë person kreativ, bashkëpunues, për secilin aktivitet trajnues dhe mentorues dhe të raportojë me kohë;
8. Të respektojë marrëveshjen me përpikëri;

## Detyrat kryesore

Trajnerët e angazhuar nga MASHT-DKA-ja, kanë këto detyra dhe obligime:

- Të analizojnë dokumentet e KK-së dhe KB-ve sipas niveleve.
- Analizojnë Udhëzuesin për zbatimin e kurrikulës së re në fushën përkatëse.
- Të prezantojnë informacionet dhe njohuritë sipas dokumenteve të Kurrikulës së re të Kosovës dhe përmbajtjeve materiale dhe shkencore.
- Përgatisin planin e trajnimit sipas seancave dhe materialet për prezantim në seancat e trajnimeve.
- Të bëjnë organizimin dhe mbajtjen e trajnimit sipas agjendës.
- Të sigurojnë lloptop dhe projektor për prezantimin e punës së tyre në seancat e trajnimit.
- Të përmbledhin – integrojnë dhe përpunojnë modelet praktike të planifikimit për shkallë të kurrikulës, planeve vjetore dhe dymujore të përgatitura gjatë trajnimit dhe marrin detyra nga kryetrajnerët dhe ju shpërndajnë mësimdhënësve, si modele pune gjatë trajnimit.
- Të përgatisin raportin e punës sipas ditëve të angazhimit për trajnimin e mësimdhënësve.
- Të përgatisin së bashku me kryetrajnerët, në konsultim me DKA-në – Kordinatorin Komunal për Zbatimin e Kurrikulës së re planin e trajnimit për të gjitha seancat e trajnimit të mësimdhënësve në komune dhe e dorëzojnë në DKA dhe në divizionin për Zhvillim profesional të mësimdhënësve në MASHT.
- Të mbajnë evidencën në mënyrë korrekte për pjesëmarrësit në trajnim, të bëjnë raporte vlerësimi për seancat e trajnimeve dhe raport vlerësimi për mësimdhënësit pjesëmarrës në trajnim dhe aspekte tjera që inkorporojnë ruajtjen e standardeve të parapara për organizimin dhe mbajtjen me sukses të trajnimit-punëtorive.

**Numri i trajnerëve sipas fushave: Tre mësimdhënës nga fusha Gjuhë dhe komunikim, dy mësimdhënës nga Matematika, tre mësimdhënës nga fusha shkencat natyrore, tre mësimdhënës nga fusha shoqëria dhe mjedisi, dy mësimdhënës nga fusha e arteve, tre mësimdhënës të niveli parafillor dhe fillor.**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bashkëpunim me DKA-në bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kriteret e ofertës do të marrë vendim për angazhimin e trajnerëve të përzgjedhur sipas fushave të Kurrikulës së re ku do të specifikohen edhe kushtet e angazhimit: Të interesuarit do të paraqesin këto dokumente:

- Kërkesën/Formularin
- Kopjen e letërnjoftimit
- Kopjen e diplomës nga kualifikimi
- CV personale dhe
- Një referencë nga drejtori i shkollës bazuar në vlerësimin e tij/saj.

Të gjitha dokumentet duhet të përcillen me dëshmi .

Në nivel të DKA-së nga një komision do të bëhet shikimi i dokumentacionit dhe mundësia e seleksionimit të kandidatëve për trajner dhe pas kësaj faze do të vlerësohet nevoja për forma tjera të seleksionimit.

Konkursi mbetet i hapur 15 nga dita e publikimit.

Aplikacioni merret në qendrën për shërbime me qytetar në hyrje të ndërtesës së komunës, zyra numër 100 kati përdhese dhe dozohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin po në të njëjtën zyre.

Drejtori i DKA-së

**Hajrush Shoshi**

